

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.97/2013, “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Liria e shprehjes garantohet në nenin 22 të Kushtetutës: “1. Liria e shprehjes është e garantuar. 2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. 3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet. 4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit. “

Garantimi i lirisë së shprehjes nuk mund të kuptohet i ndarë nga garantimi i një sërë të drejtash të tjera, si e drejta e informimit, parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës, që parashikon se: “E drejta e informimit është e garantuar. ...”. Veprimtaria e mediave audio/audiovizive normohet prej ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.22/2016, vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.56, datë 27.7.2016, dhe ligjin nr.91/2017. Ligji nr.97/2013 është i përafuar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” dhe përmbajtjen e saj, si pasojë e procesit të përafritimit të ligjeve të Shqipërisë me *acquis communautaire* të BE-së.

Ky projektligj synon transpozimin e direktivës (BE) 2018/1808, që ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për shërbimin mediatik me zë dhe figurë).

Ky projektligj ka për qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë si dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me aftësi të kufizuar, rritjen e

transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, përforcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë (*on demand service*). Në të gjejnë vend trajtimi i koncepteve të reja, si bashkërregullimi, vetërregullimi, edukimi mediatik, ofruesi i platformave të shpërndarjes së videove, shërbimi i platformave të shpërndarjes të videove, si dhe “video e krijuar nga përdoruesi”.

Po ashtu, përmes ndryshimeve propozohet rishikimi i detyrimeve të mbartjes (*must carry rules*), në linjë me direktivën 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian.

Objektivat që synohet të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- garantimi i së drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes;
- rritja e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike;
- mbrojtja e dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre;
- nxitja e vetërregullimit dhe bashkërregullimit si një plotësim i mekanizmave legjislativë, gjyqësorë dhe administrativë;
- sigurimi i aksesit në përmbajtjet audiovizive të “personave me aftësi të kufizuar”;
- përcaktimi i rregullave të reja për platformat e shpërndarjes së videove

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit, neni 70, “Përafrimi i legjislacionit...” dhe neni 103 “Shoqëria e informacionit”, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me *acquis communautaire*, përfshirë edhe Direktivën 2018/1808 (BE), është detyrim për Shqipërinë.

Ky projektligj hartohet edhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.91, datë 9 shkurt 2022, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2022-2024”, në të cilin është parashikuar transpozimi i pjesshëm i Direktivës 2018/1808/EU.

Ky detyrim buron edhe nga akte të brendshme, siç janë rezolutat e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitet 2020 dhe 2021.

Kështu në “Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2020”, rekomandohet që AMA: *“Të japë kontributin e saj në procesin e transpozimit në legjislacionin kombëtar të Direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime, ndër të tjera, synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve, rregulla të reja për platformat on-line, ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare”*.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i ndryshimeve në ligjin në fuqi nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të japë kontribut në garantimin e mëtejshëm të lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit.

Duke mbajtur në konsideratë që ligji ekzistues është tërësisht në përputhje me direktivën 2010/13, edhe ndryshimet që ka pësuar kjo direktivë, me Direktivën 2018/1808, vlerësohen të implementohen përmes ndryshimeve në ligjin ekzistues, në funksion edhe të ndryshimeve të tregut. Mjedisi i mediave audiovizive dhe sjellja e shikuesve kanë ndryshuar si rezultat i rritjes së zgjedhjes së përmbajtjes audiovizive dhe mënyrave në të cilat audienca mund të informohet.

Ndryshimet kryesore të propozuara në ligjin nr.97/2013, të ndryshuar, kanë si qëllim përcaktimin e rregullave të reja mbi vetërregullimin dhe bashkërregullimin; rishikimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve me kërkesë (VOD); rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe përcaktimin e rregullave të reja lidhur me shërbimin e platformave të shpërndarjes së videove etj.

Në projektligj përcaktohet që duhet të ketë më shumë transparencë lidhur me pronësinë e ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA). Referuar ndryshimeve përforcohet detyrimi i OSHMA-ve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Konkretisht, parashikohet marrja e masave më të rrepta për të siguruar që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe nga ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, do të vihen në dispozicion vetëm në atë mënyrë që siguron se fëmijët normalisht nuk do t’i dëgjojnë ose shohin ato. Këto masa mund të përfshijnë përzgjedhjen e kohës së transmetimit, mjetet e verifikimit të moshës ose masa të tjera teknike. Të dhënat personale të fëmijëve të mbledhura apo të nxjerra nga OSHMA-të nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si

p.sh, marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi apo për çdolloj arsye tjetër. Edhe për personat me aftësi të kufizuara janë zgjeruar dhe rritur kërkesat për OSHMA-të, duke shtuar detyrimin e tyre që në mënyrë progresive t'i bëjnë shërbimet e tyre më të arritshme për këtë kategori personash përmes masave propocionale.

Po ashtu, në projektligj përfshihen për herë të parë konceptet e “*bashkërregullimit dhe e vetërregullimit*”, përmes kodeve të sjelljes, akte që do të përcaktojnë standardet dhe praktikatat që duhet të respektohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizive.

Një tjetër risi në projektligj është përfshirja në të e konceptit “*edukimit mediatik*”, ose ndryshe aftësia, njohuria dhe të kuptuarit që u lejon individëve të përdorin në mënyrë të sigurt dhe efektive përmbajtjet e shërbimeve mediatike audiovizive. Aktualisht, nuk ka një parashikim të këtij koncepti në ligjin aktual dhe promovimi i tij është parashikuar si një nga funksionet e autoritetit rregullator.

Po kështu, në projektligj përfshihen konceptet, si: “ofruesi i platformave të shpërndarjes së videove”, “shërbimi i platformave të shpërndarjes së videove”, si dhe “video e krijuar nga përdoruesi”. Aktualisht, nuk ka një parashikim të këtyre koncepteve në ligjin aktual.

Në ligjin nr.97/2013, në nenin 87 janë parashikuar detyrimet e mbartjes, duke transpozuar pjesërisht Direktivën e Shërbimit Universal 2002/22 EC (Article 31). Me direktivën 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian, janë miratuar disa ndryshime për “*Must Carry Rules*” dhe, në këto kushte, lind nevoja e rishikimit të nenit 87 të ligjit për të qenë në harmoni me direktivën 2018/1972.

Mediat luajnë rol etik në gjenerimin e kulturës demokratike dhe propozimet ligjore kanë si qëllim që t'i ofrojnë publikut një përmbajtje sa më cilësore. Ndryshimet do të sjellin rregullimin e peizazhit mediatik, rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit lidhur me përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të, forcimin e masave lidhur me fëmijët, garantimin e të drejtave të tyre në komunikimet tregtare, mbrojtjen e të dhënave të tyre personale si dhe garantimin e së drejtës kushtetuese për informimin e personave me aftësi të kufizuara.

Grupet e prekura nga ndryshimet e propozuara janë ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, të cilët do të ngarkohen me detyrimin për respektimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore, duke qenë se fusha e zbatimit të kësaj nisme ligjore u drejtohet këtyre subjekteve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe propozohet me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit dhe lirisë së shprehjes.

Projektligji është i harmonizuar edhe me legjislacionin vendas në fuqi pasi ligji nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është tërësisht i përafruar me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010.

Propozimi i këtij projektligji për miratim nga Kuvendi i Shqipërisë është në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe nuk përfshihet në listën e akteve që ndalohen të miratohen gjatë periudhës zgjedhore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin me *acquis communautaire* dhe, konkretisht, transpozimin e Direktivës (BE) 2018/1808 që ndryshon direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë), si dhe të një neni të Direktivës 2018/1972, Kodi i Komunikimeve Elektronike.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar përbëhet nga 17 nene, konkretisht,:

Neni 1 bën një plotësim në fushën e zbatimit të ligjit në fuqi, duke shtuar dhe shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, rregullimi i të cilave është pjesë e direktivës së re të medias audiovizive 2018/1808/EU.

Neni 2 parashikon disa shtesa dhe ndryshime në nenin 3, të ligjit nr.97/2013, lidhur me përkufizimet, duke riformuluar disa nga përkufizimet për të qenë në përputhje me Direktivën 2018/1808.

Kështu ndryshon përkufizimi i termave “Shërbim mediatik audioviziv”, “Program” etj si dhe shtohen përkufizimet e termave “vendim editorial”, “edukim mediatik”, “ofruesi i platformave të shpërndarjes së videove”,

“shërbimi i platformave të shpërndarjes të videove”, si dhe “video e krijuar nga përdoruesi”.

Përfshirja e konceptit “edukim mediatik”, i cili i referohet aftësive, njohurisë dhe të kuptuarit që u lejon individëve të përdorin në mënyrë të sigurt dhe efektive përmbajtjet e shërbimeve mediatike audiovizive përbën një risi në projektin e propozuar, që shoqërohet me parashikime të tjera në ligj si në pikën 2, të nenit 19, në harmoni me sa parashikohet në nenin e shtuar 33.a të Direktivës 2018/1808/EU.

Edukimi për median ndikon në ndërgjegjësimin e audiencave të ndryshme për të drejtat e tyre në raport me OSHMA-të, për të raportuar rastet e shkeljes së etikës për të qenë të kujdesshëm në dhënien e intervistave, të cilat nuk respektojnë të drejtat e të miturve, të viktimave, parimin e prezumimit të pafajësisë, manipulimet e qytetarëve si konsumator të medias. Nga ana tjetër, edukimi për median do të rriste cilësinë e mediave dhe informimin e publikut. Në ditët tona, kur lajmet e rreme, keqinformimi dhe disinformimi, gjuha e urrejtjes, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi përbëjnë kërcënime serioze të vlerave të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, edukimi mediak i publikut, sidomos i të rinjve do të mundësojë një vlerësim dhe analizë më të mirë të mesazheve mediatike të transmetuara në mediat audiovizive.

Në këtë kuadër, në nenin 3 parashikohet një shtesë në nenin 19 “Funksionet e AMA-s”, lidhur me “edukimin mediatik”, duke i shtuar si funksion autoritetit rregullator nxitjen e ndërgjegjësimit publik, kërkimin dhe veprimtaritë për edukimin mediatik, përfshirë ndërgjegjësimin publik për “ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove”.

Në nenin 4 të projektligjit propozohet rishikimi i nenit 30 të ligjit, lidhur me përcaktimin e juridiksionit të AMA-s, duke përcaktuar se:

- Nëse selia qendrore e një ofruesi të shërbimit të medias ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, por vendimmarrja editoriale për shërbimet audio dhe/ose audiovizive realizohet në një vend të Bashkimit Europian, presumohet se ofruesi i shërbimit të medias është në juridiksionin në Republikën e Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e personelit që angazhohet në prodhimin e programeve të ofruesit të shërbimit të medias, vepron në Shqipëri si dhe, kur një pjesë e konsiderueshme e personelit që angazhohet në prodhimin e programeve të ofruesit të shërbimit të medias vepron në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend të BE-së, ofruesi i shërbimit mediatik presumohet se është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse selia e tij qendrore është në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë dispozitë përcaktohet se AMA do të krijojë listën e përditësuar të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, si dhe listën e ofruesve të platformave të shpërndarjes së videove nën juridiksionin e

Republikës së Shqipërisë, parashikim ligjor që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e transparencës së autoritetit.

Në nenin 5 të projektligjet propozohet shtimi i dy neneve 30/1 dhe 30/2, duke bërë një plotësim për ofruesit e shërbimit të platformës të shpërndarjes së videove në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 28a, të Direktivës 2018/1808/EU, si dhe parashikohen “Kodet e sjelljes” dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh gjatë përgatitjes dhe rishikimit të tyre, duke theksuar se këto akte duhet të pranohen gjerësisht nga palët e interesit; të përcaktojnë në mënyrë të qartë objektivat e tyre; të parashikojnë rregullat dhe kriteret për monitorimin e zbatimit të tyre etj. Për herë të parë në ligj rregullohen instrumentet e vetërregullimit dhe bashkërregullimit, si iniciativa në funksion të lirisë së shprehjes dhe informimit.

Kodet e sjelljes duhet:

- a) të jenë të konceptuara në mënyrë që të pranohen gjerësisht nga palët e interesit;
- b) të përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë objektivat e tyre;
- c) të garantojnë respektimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ç) të parashikojnë një monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent e të pavarur të arritjes së objektivave të synuar;
- d) të sigurojnë një zbatim efektiv, përfshirë sanksione të efektshme dhe proporcionale.

Po ashtu, në kuadër të vetërregullimit ofruesit e shërbimeve audiovizive si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove duhet të hartojnë dhe tëzbatojnë kode sjelljeje, si marrëveshje të lira mes tyre, për të zbatuar kërkesa etike dhe profesionale në ushtrimin e detyrës, në favor të rritjes së cilësisë dhe shumëllojshmërisë së programeve audiovizive. Kodet e sjelljes publikohen dhe në faqet elektronike të ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Neni 6 i projektligjit parashikon disa ndryshime dhe shtesa në rregullat e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve mediatike, përcaktuar në nenin 32, të ligjit në fuqi, lidhur me bërjen publike të informacionit mbi strukturën e pronësisë së OSHMA-ve, përfshirë pronarët përfitues.

Po ashtu, saktësohet se ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtarit të një grupi mbi baza të tilla si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinionioni politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia,

mosha ose orientimi seksual apo nxisin kryerjen e veprave terroriste, drejtpërdrejt ose tërthorazi të akteve terroriste apo mbrojtjes së veprave terroriste.

Në nenin 7 të projektligjit parashikohet rishikimi i detyrimeve të OSHMA-ve me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kështu, programet audio dhe audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, do të transmetohen vetëm në atë mënyrë që siguron se fëmijët normalisht nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato, përmes zgjedhjes së kohës së transmetimit, aplikimit të mjeteve të verifikimit të moshës ose përmes masave të tjera teknike. Masat mbrojtëse duhet të jenë në proporcion me efektet në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve. Programet audio dhe audiovizive më të dëmshme, siç është dhuna dhe pornografia do t'i nënshtrohen masave më të rrepta. Po ashtu, në këtë dispozitë përcaktohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve të cilat nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe reklamimi mbi bazë sjelljeje apo për çdolloj arsye tjetër. Janë parashikuar, gjithashtu, dhe kërkesat në lidhje me masat për sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe publikun e gjerë që duhet të përmbushen nga ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove sipas parashikimeve në pikën 1, të nenit 28b të Direktivës së re të medias 2018/1808/EU.

Neni 7 parashikon futjen e dispozitave të reja ligjore, nenet 32/1, 32/2 dhe 32/3, që lidhen me garantimin kushtetues të së drejtës për informim për personat me aftësi të kufizuara, duke përcaktuar disa kushte për OSHMA-të, që t'i bëjnë shërbimet e tyre më të arritshme për këtë kategori personash. Ky detyrim do të përmbushet gradualisht dhe ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive duhet të hartojnë plane veprimi mbi aksesin, në mënyrë progresive në shërbimet e ofruara prej tyre nga personat me aftësi të kufizuar.

Sipas kësaj dispozite, AMA, për të ofruar informacion dhe për marrjen e ankesave në lidhje me çështjet e përmendura në këtë nen, cakton një pikë kontakti, lehtësisht të arritshme për personat me aftësi të kufizuar.

Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive sipas nenit 32/2 duhet të sigurojnë që informacioni në rast emergjencash, përfshirë komunikimet publike dhe njoftimet në rast fatkeqësish natyrore, të ofrohet në mënyrë të tillë që të jetë i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar.

Neni 32/3 parashikon disa rregulla për transmetimin e programeve me interes të përgjithshëm, duke ngarkuar ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive me detyrimin për marrjen e masave për t'i dhënë hapësirën e duhur këtyre programeve. OSHMA-të duhet të garantojnë që programet dhe shërbimet mediatike audiovizive të tyre të mos transmetohen në formë të shkurtuar, të

ndryshohen, të ndërpriten ose të mbivendosen për qëllime tregtare, pa pëlqimin e ofruesit të shërbimit mediatic audioviziv. Në këtë dispozitë përcaktohen edhe rastet e përjashtimit nga keto detyrime.

Neni 8 parashikon ndryshime lidhur me komunikimet me natyrë tregtare, duke krijuar më tepër fleksibilitet në ndarjen e fashave të komunikimeve me natyrë tregtare. Kështu, transmetimi i reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta, gjatë fashës kohore nga ora 6:00 deri në orën 18:00 nuk duhet të tejkalojë 20% të kësaj fashe orare. Transmetimi i reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta gjatë fashës kohore nga ora 18:00 deri në orën 24:00 nuk duhet të tejkalojë 20% të kësaj fashe orare.

Në nenin 8 përcaktohen edhe rastet kur nuk zbatohen përcaktimet e pikës së mësipërme lidhur me njoftimet e vetë OSHMA-ve, vendosjet e produktit, kornizat neutrale etj.

Neni 9 parashikon ndalimin e komunikimeve me natyrë tregtare për cigaret, produktet e duhanit, duke shtuar detyrimin edhe për cigaret elektronike dhe enët rimbushëse. Po kështu, parashikon riformulime dhe shtesa në detyrimet lidhur me transmetimet audiovizive, në komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare që shoqërojnë ose përfshihen në programet për fëmijë, të ushqimeve dhe pijeve, që përmbajnë substanca të dëmshme ose të padobishme për shëndetin fizik të tyre, veçanërisht ato me përmbajtje të lartë yndyre, acide yndyrore, kripe, sode e sheqeri, që janë tej normave të lejuara për një dietë ushqimore të shëndetshme për të miturit, sipas udhëzimeve të AMA-s. Gjithashtu, në mbrojtje të kategorisë së fëmijëve, pas fjalës “morale” shtohet fjala “mendore”.

Duhet theksuar se në ligjin nr.97/2013 parashikohet se OSHMA-të dënohen me gjobë për sponsorizimet, reklamat e produkteve të duhanit (neni 45, neni 42, pika 4) nga AMA në masën 40 000- 400 000 lekë. Po ashtu, në ligjin nr.9636/2006, i ndryshuar, në nenet 13-14 përcaktohen detyrimet për median audiovizive për reklamimin dhe sponsorizimin e programeve Radio/Tv, duke përcaktuar edhe gjobë për OSHMA-të, që vendoset nga inspektoriati që mbulon çështjet e shëndetit, duke rezultuar që për të njëjtën kundërvajtje administrative të parashikohen sanksion gjobe në akte të ndryshme ligjore.

Neni 10 parashikon ndryshime po në komunikimet me natyrë tregtare, lidhur me spotet e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta, duke saktësuar se spotet e izoluara të reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta lejohen në programet sportive, duke përbërë përjashtim nga rregullat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Sipas propozimit të projektligjit, transmetimi i filmave, veprave kinematografike dhe programeve të lajmeve mund të ndërpriten nga reklama,

shitje të drejtpërdrejta ose të dyja bashkë jo më shpesh se çdo 30 minuta. Këtu nuk përfshihen serialet dhe dokumentarët.

Sa i përket programeve për fëmijë, ndalohej ndërfutja e shitjeve të drejtpërdrejta gjatë programeve për fëmijë. Ky parashikim lind nevojën e rishikimit të pikës 4, të nenit 43, të ligjit që përcakton se *“Transmetimi i programeve për të miturit mund të ndërpritet nga spote reklamash ose shitjesh të drejtpërdrejta jo më shpesh se çdo 30 minuta, nëse kohëzgjatja e programit është më shumë se 30 minuta”*, duke hequr fjalët "ose shitjesh të drejtpërdrejta".

Në nenin 11 propozohet ndryshimi i nenit 44 i ligjit në fuqi mbi vendosjen e produkteve. Vendosja e produkteve lejohet në programet e ofruesve të shërbimeve mediatike, përveç programeve të lajmeve, çështjeve aktuale, mbi çështjet konsumatore, me natyrë fetare dhe programeve për fëmijë.

Neni 12 parashikon ndryshime lidhur me sponsorizimin, duke shtuar edhe në këtë nen *“cigaret elektronike si dhe enët rimbushëse”*, krahas fjalëve *“prodhimeve të tjera të duhanit”*.

Neni 13 parashikon rishikimin e kërkesave për ofruesit e shërbimeve mediatike audio/audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit (*on demand service*), duke përcaktuar si detyrim që këto subjekte të garantojnë që në katalogët e tyre të kenë të paktën 30% të tregut të veprave evropiane dhe që ato të jenë të dukshme.

Po ashtu, propozohet që shërbimet mediatike audio dhe/ose audiovizive, sipas kërkesës së përdoruesit, të ofruara nga operatorët e shërbimit të medias promovojnë, kur është e mundur dhe me mjete të përshtatshme, prodhimin e veprave evropiane, duke kontribuar financiarisht në prodhimin e veprave evropiane, përmes investimit të drejtpërdrejtë në përmbajtje dhe/ose kontributit në fondin e filmit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 14 parashikon ndryshime në nenin 87 të ligjit në fuqi, lidhur me detyrimet e mbartjes, duke parashikuar se AMA ka të drejtë t’u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive, ofrimin e shërbimeve shoqëruese të tyre, udhëzuesit elektronikë të programit (EPG), ndërfaqet e programeve aplikative, veëanërisht shërbimeve që mundësojnë akses të përdoruesve me nevoja të veçanta shqisore. Këto detyrime vendosen ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilave shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish fundorë si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive.

Ky parashikim ligjor ka si qëllim marrjen e programeve që do të vlerësohen me interes për publikun, ofrimin e shërbimeve të tyre shoqëruese nga shikuesit e zonave më të largëta që nuk kanë mënyra të tjera për marrjen e informacionit pa pagesë, si dhe garantimin e aksesit edhe nga personat me nevoja të veçanta shqisore, kategori e cila nuk është e përmendur në nenin 87 të ligjit në fuqi.

Neni 15 propozon shtesën e dy pikave 9/1 dhe 9/2, në nenin 133 të ligjit 97/2013, lidhur me masat administrative për ofruesit e shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove.

Neni 16 parashikon zëvendësimin kudo në tekstin e projektligjit të fjalës “... të mitur” me “... fëmijë”, në përputhje me terminologjinë e ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sipas të cilit fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç.

Neni 17 parashikon hyrjen në fuqi të këtij ligji 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA si autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar me kontributin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në bashkëpunim më Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në kuadër të grupit ndër-institucional të punës për integrimin evropian për kapitullin 10, “Shoqëria e informacionit dhe media”.

Projektligji është konsultuar përmes regjistrit të konsultimeve publike gjatë periudhës 12.9.2022 – 10.10.2022, si dhe projektligji i rishikuar gjatë periudhës 12 - 26.12.2022. Gjatë konsultimit publik u paraqitën sugjerime nga dy organizata të shoqërisë civile në mbrojtje të grave. Gjithashtu, në rrugë elektronike paraqitën disa komente Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe pranë AMA-s disa operatorë të shërbimeve audiovizuale. Për sugjerimet e dhëna është kthyer përgjigje duke sqaruar që pjesa më e madhe e tyre janë pjesë e rregullimit përmes akteve nënligjore si kodi i transmetimeve që është në

proces rishikimi, konsultimi nga AMA. Gjithashtu, në kuadër të konsultimeve nga MIE dhe AMA në datën 26 janar 2023, u zhvillua një takim konsultativ me Shoqatën Shqiptare të Grave ne Media (AËA) në lidhje me propozimet e tyre për disa ndryshime për forcimin e barazisë gjinore në media.

Projektligji është konsultuar me Komisionin Evropian, *DG Near* dhe *DG Connect* si dhe me ekspertët e Organizatës Evropiane Observatore të Medias Audiovizive. Në datën 8 nëntor 2022, u zhvillua një takim teknik me përfaqësuesit e Komisionit Evropian. Në këtë takim nga përfaqësuesit e Komisionit Evropian u kërkua që të përfshiheshin në projektligj rregullime për platformat e shpërndarjes së videove pasi përbëjnë një rregullim të ri të rëndësishëm në kushtet e mjedisit të ri mediatik. Komisioni Evropian u shpreh se përfshirja e këtyre rregullimeve përbën kusht për vijimin e përfitimit të Shqipërisë nga programi Creative Europe. Nga ekspertët e Organizatës Evropiane Observatore të Medias u dhanë sugjerime dhe eksperiencia të vendeve të BE-së për rregullimin e platformave online.

Projektligji i rishikuar u ridërgua për mendim pranë Komisionit Evropian në fund të muajit nëntor 2022. Në datën 21 dhjetor 2022, Komisioni Evropian, *DG Connect* shprehet pozitivisht për projektligjin e rishikuar duke nënvizuar se projektligji ku përfshihen rregullat për platformat e shpërndarjes së videove plotëson kushtin për vijimin e Programit Creative Europe për Shqipërinë.

Projektligji është konsultuar me ministrinë: Ministria e Drejtësisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE